



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa nr. 05-354/03-27095/24 dt. 21.02.2024, e pronarit Ekrem Hasani, përmes së cilës kërkohet të caktohen kriteret për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, me etazhitet P+1, në parcelën kadastrale nr. 177-42 ZK. Hajvali, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 12.03.2024 deri më 16.03.2024, në email adresën: urbanizmi@rks-gov.net

| Kushtet e propozuara të ndërtimit: | |
|--|--|
| a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: | Shtëpi individuale e banimit P+1 |
| b. Vija rregulluese | Vija e parcelës kadastrale |
| c. Vija ndërtimore | 3-5m` nga vija e parcelës kadastrale |
| d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike | 7.20m`/VN (Lindje) |
| e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale. | 7.20m`/min 3.00m` (Veri) 7.20m`/min 3.00m` (Perëndim) 7.20m`/~9.00m` (Jug) |
| f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP) | 30% |
| g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN) | // |
| h. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ) | 40% |
| i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN) | 60% |
| j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve | 1VP/njësi banesore |
| k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese | Po |
| l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> | |
| m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona për rreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro: | |
| n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro: | |

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 06/2017 dt. 23.05.2017, për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, neni 13, paragrafi 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përfshihet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrës



Faqe 1 prej 1